



## Shpallje për Programin e Trajnimit të Trajnerëve

### për Noterët, Përmbauesit Privat, Ndërmjetësuesit dhe Administratorët e Falimentimit

Projekti i financuar nga BE “Mbështetje Profesioneve të Lira Ligjore dhe Odës së Avokatëve” në Kosovë (Projekti) **shpall thirrje për trajnerët** që të marrin pjesë në **Programin e Trajnimit të Trajnerëve (ToT)** për **katër profesionet e lira ligjore (PLL) në Kosovë**: Noterët, Përmbauesit Privat, Ndërmjetësuesit dhe Administratorët e Falimentimit.

#### ➤ Programi i Trajnimit të Trajnerëve

- **Qëllimi: të zhvillohet një program i qëndrueshëm i trajnimit për katër profesionet e lira ligjore** të lartpërmendura. Ai do të dedikohet për zbatimin e një metodologjie mësimore për arsimimin e të rriturve, zhvillimin e kurrikulave dhe përgatitjen e teksteve shkollore.
- **Koha e pritshme për Programin e Trajnimit të Trajnerëve:** Shkurt 2018 – Shtator 2018.
  - ✓ **Kohëzgjatja në tërësi e Programit: 20 ditë**, e ndarë në 4 seanca të trajnimit nga 5 ditë secila ku përfshihen edhe detyrat me shkrim në mes të seancave, me kohën e përgatitjes së parashikuar në mes të sesioneve 5 deri në 10 orë.
  - ✓ Programi është i limituar për 25 persona dhe ka për synim një përfaqësim të barabartë të katër PLL-ve.
- **Periudhat tentative të seancave të ToT:** 5 ditë pune në pjesën e dytë të muajit Shkurt 2018 (seanca e parë e ToT-së), 5 ditë pune në Maj 2018 (seanca e dytë e ToT-së), 5 ditë pune në Korrik 2018 (seanca e tretë, grupi i parë i pjesëmarrësve) dhe 5 ditë pune në Shtator 2018 (seanca e tretë e ToT-së, grupi i dytë i pjesëmarrësve).
  - ✓ Pjesëmarrësit duhet që t’i përcjellin të gjitha seancat. **Nevojitet minimumi 80% e pjesëmarrjes** për përfundimin dhe certifikim nga ky program.
- **Pasojat e certifikimit:** Mundësia për kryerjen e trajnimeve në bazë të kërkesës nga përfaqësuesit e PLL-ve të lartpërmendura dhe/ose organizatat e tyre profesionale përkatëse.
- **Kërkesat për kandidatët:**
  - diplomë nga fakulteti juridik, ekonomik, apo ndonjë drejtim tjetër për këto PLL
  - së paku 5 vite përvojë profesionale përkatëse
  - njohuri për kornizën dhe procedurat ligjore dhe aftësinë për të mbledhur dhe analizuar përmbajtjen e trajnimit
  - qytetar i Kosovës



- përvojë të mëparshme të trajnimit, do të ishte përparësi.
- të jetë përfaqësues i një nga grupeve të synuara si më poshtë:
  - ✓ përfaqësuesit të cilët praktikojnë një nga 4 PLL-të e lartpërmendura (noterinë, ndërmjetësimin, përbarimin dhe administrimin e falimentimit);
  - ✓ ligjërues në universitete,
  - ✓ gjyqtarë,
  - ✓ prokurorë,
  - ✓ punëtor në Ministrinë e Drejtësisë, ose
  - ✓ avokatë

Kandidatët duhet që të i) ndjekin qëllimin e zhvillimit të një trajnimi të vazhdueshëm të strukturuar për PLL-të e lartpërmendura dhe rritjes së kompetencave dhe profesionalizmit të tyre, ii) jenë profesionalist të njohur të njërës nga fushat e PLL-ve të lartpërmendura, dhe iii) jenë në gjendje të mbajnë trajnime për PLL-të.

➤ **Dokumentet e detyrueshme:**

1. Letra motivuese, përfshirë shprehjen e gatishmërisë së tij për të marrë pjesë në Programin ToT;
2. CV në formatin EuropeAid

Kandidatët duhet t'i dërgojnë aplikacionet e tyre tek Znj. Engjellushe Januzi, kontakti: [engjellushe.januzi@bseurope.com](mailto:engjellushe.januzi@bseurope.com); +381 38 778 095

- **Afati i fundit për aplikim:** 22 Dhjetor 2017
- **Kandidatët e përzgjedhur** do të thirren për **intervistë** në mes datave 8 – 12 Janar 2018.
- **Përfundimi i procesit të përzgjedhjes:** Mesi i muajit Janar 2018.
- **Projekti:** Qëllimi kryesor i projektit është fuqizimi i gjyqësorit përmes forcimit të profesioneve të lira ligjore dhe Odës së Avokatëve. Qëllimi i këtij projekti është funksionalizimi i plotë i sistemit të profesioneve të lira ligjore duke forcuar Departamentin për Profesione të Lira Ligjore dhe kapacitetet e profesioneve të lira ligjore dhe Odës së Avokatëve.